



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 14 mars 2013

**Fillim i projektit të financuar nga BE-ja: "Avancim i
mëtejshëm i Sistemit për identifikim të parcelave tokësore
në kuadër të Administratës së integruar dhe sistemit për
kontroll"**

(Qendra Informative e BE-së)

Fjalim
Ambasador Aivo Orav
Shef i Delegacionit të BE-së

I nderuari Ministër Dimovski,

I nderuari z. Rowlands

Zonja dhe zotërinj,

Është nder të shënohet fillimi i projektit të financuar nga BE-ja për mbështetjen e sektorit bujqësor.

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian me 700.000 euro dhe është pjesë e përpjekjeve tona, për ta bërë sektorin bujqësor të gatshëm për anëtarësim në BE.

Bujqësia luan rol kyç në ekonomitë rurale, në menaxhimin e resurseve natyrore dhe në mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazhit. Zonat rurale përbëjnë 90% të territorit të Bashkimit Evropian (BE), nga të cilat, më shumë se gjysma kultivohen nga bujqit.

Politika e përbashkët bujqësore (CAP) e BE-së synon t'i mbështesë të ardhurat e bujqve dhe në të njëjtën kohë i inkurajon ata që të prodhojnë produkte me cilësi të lartë në mënyrë të qëndrueshme.

Shumë bujq nga BE-ja kanë përfituar nga grantet për modernizimin e fermave dhe makinave të tyre, me qëllim të përmirësimit të cilësive të bagëtisë së tyre dhe kushtet ku ato kultivohen. Sfida është që të sigurohet se modernizimi do t'i

ndihmojë bujqit që të bëhen ekonomikisht më konkurrent dhe të aplikojnë teknika të qëndrueshme për mjedisin.

CAP nuk mund të zbatohet në mënyrë efikase pa politikë serioze dhe instrumente për kontroll sikur Administrata e integruar dhe sistemi për kontroll (IACS). Sistemi për identifikimin e parcelave tokësore është një sistem i cili i kalkulon subvencionet dhe bën kontrollin e pagimit të granteve për bujqit. Krahas kësaj, ai ofron informacione të vlefshme për politikat e ardhshme në sferën e bujqësisë.

Bujqësia padyshim është një nga pjesët më të vështira të negociatave për anëtarësim. Ajo paraqet gjithashtu një nga pjesët më të komplikuar të legjislacionit të BE-së kur bëhet fjalë për implementimin e ligjeve.

Nga bujqit kërkohet që të respektojnë një varg të ligjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e ushqimit, shëndetin e kafshëve dhe mirëqenien e tyre, masat fitosanitare dhe mbrojtjen e mjedisit. Qëllimi përfundimtar është që të sigurojë ushqim të sigurt me cilësi të lartë në tryezat tona dhe në të njëjtën kohë ta mbrojnë mjedisin tonë.

Për këto arsye, por edhe për shkak se bujqësia është sektor shumë i rëndësishëm për zhvillim socio-ekonomik si edhe për punësimet e vendit, BE-ja do të vazhdojë të sigurojë fonde të vazhdueshme për këtë sektor, në vitet në vijim.

Projektin që jemi duke e filluar sot do t'i ndihmojë autoritetet nacionale në implementimin më efikas të programeve nacionale për subvencionim, pagesat direkte, si edhe zhvillimin rural dhe skemat e tjera nacionale për përkrahje. Më vonë, do ta ndihmojë vendin në përgatitjet për shfrytëzimin e fondeve evropiane për bujqësi, që do të jenë në dispozicion pas anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Përfituesit përfundimtarë të projektit do të jenë bujqit. Ata do të fitojnë procedura më të thjeshta për të aplikuar për ndihma dhe për kontrolle më efikase.

Ju dëshiroj punë të suksesshme gjatë plotësimit të objektivave të projektit.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj.